



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:092466

Datë: 09.07.2021

Numri i dokumentit: 01980769

**C.nr.100/2020**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, në përbërje nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike të paditëses Z., G., nga Skenderaj, të cilën e përfaqëson me autorizim ... avokat në Glllogoc, kundër të paditurës K., S., -D., për Sh., dhe M., S., që e përfaqëson me autorizim ...., për kompensim pagave jubilarë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me dt.15.06.2021 me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse, me dt.30.06.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** si e bazuar kërkesë padia e paditëses Z., G., nga Skenderaj.

**DETYROHET** e paditura K., S., – D., për Sh., dhe M., S., që paditëses t’i kompensoj dy paga jubilarë në shumën prej 973.38 euro për përvojën e punës mbi 20 vite si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për hartim të padisë shumen prej 104 euro, takse për padinë shumen prej 20 euro dhe për përfaqësimin e avokatit në një seancë shumen prej 135 euro, me kamatën ligjore në normën prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit në afat prej 15 dite.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes përfaqësuesit me autorizim me padinë e dorëzuarë ne gjykatë ka theksuar se është punëtore në Q., K., te M., F., ne S., nga dt..... dhe tani ka përvojë punë gjithsej 20 vite e 4 muaj, kjo dëshmohet me provat e bashkangjitura padis , si vërtetimi i punësimit, kontrata e punës.

Me dt. 12.06.2018 ka hyre ne fuqi K., K., S., ku në bazë te kësaj paditësja bazuar ne dipozitat e nenit 17 par. 3 i takon e drejta e shpërblimit ne dy paga të plota jubilarë.

Paditësja ka ushtuar kërkesë në afat ligjor të e paditura për pagesën e pagave jubilarë por edhe përkundër obligimit te saj që ta bëj përmbushjen vullnetarisht këtë pagese nuk e ka kryer.

Sa i përket lartësisë se pagës qe duhet te merret bazë për llogaritje kemi dëshmuar me provë në shkresat e lëndës.

Më parashtrësën e dt. .... e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë për dy paga jubilarë në shumën prej 973.38 euro qe duhet te paguhen më kamatën normën prej 8% nga dita e ushtrimit të padis qëndrim te cilin nuk e ndryshoj gjatë shqyrtimit kryesorë të mbajtur me 15.06.2020 dhe në

fjalën përfundimtare të dorëzuar me dt.06.05.2021 ku përveç kompensimit të pagave jubilarë kërkoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 269 euro.

E paditura gjatë shqyrtimit kryesore e kundërshtoj në tërësi kërkesë-padinë si të bazuar me arsyetimin se kontrata K., S., është duke u vlerësuar ligjshmëria e saj në Gjykatën Themelore në Prishtinë për arsye se konsiderojmë se e njëjta është në kundërshtim me aktin me të lartë juridik Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe akteve tjera ligjore.

Prandaj për këto arsye i propozoj gjykatës që padinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të bazuar.

Gjykata më qëllim të konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në çështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së i nxori dhe i administroi të gjitha provat e propozuara nga ndërgjyqësit të shënuara në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor me dt.15.06.2021 një nga një dhe të gjitha së bashku duke i krahasuar njëri me tjetrin nga të cilat rezulton se kërkesë-padia e paditëses është e themeltë.

Prej kontratës së punës nr.1/497 nr. L.A e datës .... konstatohet se paditësja është punësuar në Q., në Skenderaj në vendin e punës motër medicinale nga dt. 10.10.1999.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Q., në Skenderaj nr. 367/019 nr. L.A dt.... konstatohet se paditësja me profesion motër medicinale e lindur me 21.04.1959 është në marrëdhënie pune nga dt. 10.10.1999 të e paditura si infermiere në vendin e punës përgjegjëse e depos së barnave.

Në bazë të këtyre provave vërtetohet se paditësja nga dt. 10.10.1999 kur e ka filluar punën dhe deri me ditën e ushtrimit të padisë ka përvijën e punës mbi 20 vite. Prej kërkesës së paditëses të ushtruar me dt.11.11.2019 numër .... konstatohet se ka kërkuar kompensimin e dy pagave jubilarë, por nga e paditura e ka marrë njoftimin me datën 10.10.2019 se lidhur me zbatimin e Kontratës Sektoriale nuk mund të vendoset për kërkesën e paditëses sepse është në vlerësim kushtetutshmëria – opinionin e kësaj kontrate .

Mbi këtë bazë gjykata vlerëson se paditësja në aftin ligjor në përputhje me dispozitat e nenit 79 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-2012 ka kërkuar mbrojtje gjyqësore në gjykatë.

Bazuar në provat e administruara me lartë gjykata vërtetohet se kërkesë-padia e paditëses është e bazuar në dispozitat e nenit 17 të K., K., S., nr. por. 05-3815 dt. 12.06.2018, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerën..” ndërsa në nenin 3.2 thuhet “për 20 vite të përvijës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy pagave mujore të tij ..”.

Bazë për llogaritjen e dy pagave jubilarë janë marrë pagat e fundit që i ka realizuar paditësja në shumën prej 486.69 euro që dëshmohet nga qarkullimi për llogari të dt. 01.11.2019 prandaj sipas këtyre pagave është aprovuar shumën prej 973.33 euro .

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar si rezultat i provave të administruara është konstatuar se padia e paditëses është e mbështetur në provat e propozuara dhe plotësisht është në Kontratën Kolektive Sektoriale.

Në rastin konkret gjykata i zbaton dispozitat e nenit 90 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 ku behet fjale për marrëveshje kolektive ndërsa në par. 5 shprehimisht thuhet “Marrëveshja Kolektive vlejnë për ata punëdhënësit dhe punëmarrësit të cilët marrin për sipër detyrime të përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Nga kjo rrjedh konkludimi se marrëveshja e nënshkruar nga përfaqësuesi i Sindikatës së Punësuarve dhe Ministria kompetente ka prodhuar efekt juridik për punëdhënësit për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kjo kontrate.

Gjykata i vlerësoj gjitha kundërshtimet e palës së paditur që kanë të bëjnë me K., K., S., është dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në gjykatën kompetente por ky pretendim nuk është relevant sepse deri me tani gjykatës nuk i është dorëzuar ndonjë prove se ndaj kësaj kontrate nga gjykata kompetente është nxjerr ndonjë vendim mbi caktimin e masës së përkohshme për pezullimin e efekteve të kontratës, prandaj këto kundërshtime nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që pala e paditur t'i bartë shpenzimet procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 260 euro është i bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, ndërsa vendimi që shumat e lartpërmendura të paguhen me kamatën ligjore në normën prej 8% është iu bazuar në dispozitat e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së nr.04/L-077.

Me sa u tha më lartë konform dispozitat e nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**C.nr.100/2020, me dt.30.06.2021**

**Gjyqtari**  
Hajrullah Aruqi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.